

**SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A.**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Korçë më, 22.01.2025

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT:**

"Ndërtimi i ujësjetllësit në fshatin Zvezdë, Bashkia Maliq".

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45247130-0

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**79.975.219,87 (shtatëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e dyqind e nëntëmbëdhjetë presje tetëdhjetë e shtatë) Leke pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 me vlerë 1.599.504,40 (një milion e pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e katër presje dyzetë) Leke (2% të vlerës së përlllogaritur të kontratës).*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8.*

*c. Formulari i ofertës ekonomike, sipas Shtojcës 1.*

*d. Formulari Lista e Çmimeve sipas Zërave të Preventivit, sipas Shtojcës 2.*

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 31.990.087,95 (tridhjetë e një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë e tetëdhjetë e shtatë presje nëntëdhjetë e pesë) Leke pa TVSH (40% e fondit limit të prokuruar).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet bazuar në dispozitat e sipërpërmendura ku përcaktohet:

Autoriteti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të **xhiros vjetore** të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare**. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) **vlerën e përllogaritur të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.**

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare **konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.**

Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Ajo i shërben UKRK Sh.A, për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës.

*Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*

### **2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 39.987.609,94 (tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntë presje nëntëdhjetë e katër) Lekë pa TVSH dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 79.975.219,87 (shtetëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e dyqind e nëntëmbëdhjetë presje tetëdhjetë e shtatë) Leke pa TVSH.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

(Shënim: të përcaktohen dokumentet konkrete që kërkohen për të dëshmuar përvojën e mëparshme të ngjashme me sektorin privat, të cilat janë të nevojshme dhe i shërbejnë AK për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e ngjashme për një objekt të vetëm të jete në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, ose të jenë minimalisht sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punë e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerat si më sipër, që janë brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor UKKO SH.A., për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar nga AK.

Shënim: (Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi).

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë MIE/ ose MPPT/ ose MTI, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- a. NP – 1 A (Punime gërmimi në tokë)
- b. NP – 2 A (Ndërtime civile dhe industriale)
- c. NP – 4 A (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale)
- d. N.P – 7 C (Ujësjiellësa, gazsjellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje)

### **PUNIME SPECIALE NDERTIMI**

- a. N.S. - 18 A (Punime topogjeodezike)
- b. N.S. - 20 A (Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë)

*(Shënim: përcaktoni kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 ”Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike , që ushtrojnë veprimtari ndërtimi.”, i ndryshuar.

*(Shënim: përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor që parashikon licencimin në fushën e zbatimit të punimeve të ndërtimit, kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).*

Kriteri lidhur me kategorinë e licencave profesionale, në fushën e zbatimit në ndërtim, nivelet e klasifikimit të kategorive janë në përputhje me natyrën e kontratës dhe në përpjestim me volumet e punimeve.

Vendosja e këtij kriteri, që ndikon drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, bazohet në:

- a. Tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet dhe vlerën limit të parashikuar;
- b. Zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe vlerat e parashikuara në secilin prej tyre në hartimin e fondit limit;
- c. Përshkrimin e veprimtarive konkrete të parashikuara për t’u realizuar në specifikimet teknike;
- d. Kategoritë e punimeve të zbatimit në ndërtim, përshkrimin e secilës prej tyre dhe vlerat në lekë që i përkasin klasifikimeve të specifikuara në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 ”Për

miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike , që ushtrojnë veprimtari ndërtimi.”, i ndryshuar;

Për:

a.NP – 1 A (Punime gjurmimi në tokë)

b.NP – 2 A (Ndërtime civile dhe industriale)

c.NP – 4 A (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale)

d. N.P – 7 C (Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje)

### **PUNIME SPECIALE NDERTIMI**

a.N.S. – 18 A (Punime topogjeodezike)

b.N.S.-20 A ( Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë)

Niveli i klasifikimit korespondues është niveli “A”, i cili është për vlerë pune 0-20 milion Lekë.

Niveli i klasifikimit korespondues është niveli “A” i cili është për vlerë pune 0-20 milion Lekë.

Niveli i klasifikimit korespondues është niveli “C”, i cili është për vlerë pune 50-100 milion Lekë.

Shpjegime për kategoritë e punimeve të zbatimit në ndërtim.

#### **NP – 1 A (Punime gjurmimi në tokë).**

Konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

#### **NP – 2 A (Ndërtime civile dhe industriale)**

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të parandëruar, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

#### **NP – 4 A (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale)**

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvaji, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndërë paqëndrueshmërinë mbi "goma", "hekur", "zona", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

#### **N.P – 7 C (Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje)**

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin "e shërbimit hidrik kompleks" dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta, si edhe në të gjitha impiantet mekanike të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, ujësjiellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura

#### **N.S. – 18 A (Punime topogjeodezike)**

Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

#### **N.S.-20 A (Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë)**

Përfshihen shpimet për të vlerësuar gjeologjinë për ndërtimin e objektit inxhinierik. Shpimet për ujë dhe puse.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

<b>Kategoria e kërkuar</b>	<b>Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</b>	<b>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</b>	<b>Niveli i klasifikimit i kërkuar për</b>	<b>Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në</b>

			<b>kategorinë respektive</b>	<b>kategorinë përkatëse</b>
NP – 1 A	Punime gjermimi në tokë	Gjermim dheu me ekskavator goma 0.25 m <sup>3</sup> , në kanale gjeresi deri 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në tokë  Gjermim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir	0-20ml leke	9.715.088
NP – 2 A	Ndërtime civile dhe industriale	Ndërtim depo e re me volum 150 m <sup>3</sup> dhe puseta ajrimi etj.	0-20ml leke	9.632.497
NP – 4 A	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, linja tramvai ,metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale	Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm,  perhapur e ngjeshur me makineri  Shtrese stabilizant t=10cm  Shtrese binderi me granil gur kave, 5cm, me makineri  Shtrese asfaltbetoni me granil guri  kave, 4cm, me makineri	0-20ml leke	4.792.568
NP – 7 C	Ujësjetës, gazsjetës, vajsjetës, vepra kullimi e vaditje	FV Tuba e rakorderi ujesjetesi PE me diametra të ndryshëm	51-100 milion	55.401.094

		Ndertimi i rrjetit te brendshem dhe te jashtem  Ndertim pike-lidhje kryesore  Pika lidhje me rrjetin e ujesjellesit  F.V. saracineska me aks teleskopik me dimaetra te ndryshem		
N.S.-18A	Punime topogjeodezike	Ndertimi i AS_BUILD sipas kerkesave te specifikimeve teknike  FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PE me diametra të ndryshëm	0-20ml leke	14.797.295
N.S.-20A	Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë	Punime per pusin	0-20ml leke	2.008.269

2.2.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

**1 (një) Inxhinier Hidroteknik ose 1 (një) Inxhinier Ndertimi;**

**Shënim:** Për këtë pikë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr. 8.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorezojë pranë AK, ***përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit***, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë dokumentat provues: *kontratë pune të vlefshme dhe diplomë.*



**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ne Ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierin Hidroteknik ose 1 (një) Inxhinier Ndertimi në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit.

*Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza profesionale e inxhinierit drejtues janë:*

<p>1 (një) Inxhinier Hidroteknik ose 1 (një) Inxhinier Ndërtimi</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PE me diametra të ndryshëm</li> <li>- Ndertimi i rrjetit te brendshem</li> <li>- Ndertimi i linjes se jashtme</li> <li>- F.V. saracineska me aks teleskopik me dimaetra te ndryshem</li> <li>- Ndertim pusete shuarje</li> <li>- Shtrese binderi me granil gur kave,5cm,me makineri</li> <li>- Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri</li> <li>- Ndertim depo e re me volum 150 m3</li> </ul>
---	--

*(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, nëse është rasti, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).*

2.2.4. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- a. 1 (një) Inxhinier Gjeodet / Topograf / Markshajder
- b. 1 (një) Inxhinier Hidroteknik ose 1 (një) Inxhinier, në varësi të asaj çka është drejtuesi teknik: nëse drejtuesi teknik është Inxhinier Hidroteknik, atëherë duhet edhe një Inxhinier Ndertimi, ndërsa nëse drejtuesi teknik është Inxhinier Ndertimi atëherë duhet edhe një Inxhinier Hidroteknik.
- c. 1 (një) Inxhinier Mekanik
- d. 1 (një) Inxhinier Shpimesh

**Shënim:** Për këtë pikë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë dokumentat provues :

*kontratë pune të vlefshme dhe diplomë.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ne Ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates dhe zërat e punimeve. Nevoja për Inxhinier Gjeodet / Topograf / Markshajder , Inxhinier Hidroteknik ose Inxhinier Ndertimi, Inxhinier Mekanik dhe Inxhinier Hidrogeolog është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit.

*Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza profesionale e inxhinierëve jane:*

1 (një) Inxhinier Hidroteknik	-FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PE me diametra të ndryshëm -Ndertimi i rrjetit te brendshem -Ndertim puseta -Ndertimi i linjes se jashtme -F.V. saracineska me aks teleskopik me diametra të ndryshëm
1 (një) Inxhinier Ndertimi	-Ndërtim depo e re me volum 150 m3 -Shtrese binderi me granil gur kave,5cm,me makineri

	-Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri
1 (një) Inxhinier Gjeodet / Topograf / Markshajder	-Ndertimi i AS_BUILD sipas kerkesave te specifikimeve teknike -FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PE me diametra të ndryshëm -Ndertimi i linjes se jashtme
1 (një) Inxhinier Mekanik	-Instalime hidro-mekanike ne depo dhe puseta
1 (një) Inxhinier Shpimesh	-Punime për pusin

*(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, nëse është rasti, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).*

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikoje prezencën në objekt të personelit stafit kryesor dhe mbështetës të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merrem masa për ndërprerjen e kontratës

2.2.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/ të kualifikuar, si më poshtë:

- a. 4 (katër) Hidraulikë
- b. 4 (katër) Karpentierë
- c. 4 (katër) Hekurkthyes
- d. 2 (dy) Teknikë ndërtimi
- e. 2 (dy) Manovratorë
- f. 1 (një) Teknik mekanik
- g. 1 (një) Bojaxhi/Suvaxhi
- h. 1 (një) Murator
- i. 1 (një) Hidroizolues
- j. 1 (një) shofer
- k. 10 (dhjetë) punëtorë krahu

**Shënim:** Për këtë pikë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorezojë pranë AK, ***përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit***, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë dokumentat provues :

Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve/apo deshmi aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndertimit dhe punimeve në toke e lëshuar nga DPSHTRR, si dhe kontratat e punës të vlefshme.

#### **Sqarojmë se për 10 punëtorët e krahut duhet të paraqiten vetëm kontratat e punës të vlefshme.**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, si dhe në Ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Bazohet në përcaktimin ligjor që kritret duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Kërkesa për disponimin e 4 hidraulikëve është vendosur sepse këta punonjës të kualifikuar do të shërbejnë për montimin e tubacioneve kryesore të ujësjes, si dhe ndertimin e pikave të lidhjes me ujë për të gjitha objektet me këto tubacione. Gjithashtu hidraulikët do të kryejnë edhe montimin e tubacioneve të linjave të dërgimit, si dhe lidhjen e tyre me depon. Kjo kërkesë përputhet pra me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 4 karpentierëve të cilët do të shërbejnë për ndertimin e pusetave dhe punimet e betonit dhe kallëpeve të betonimit të depon. Kjo kërkesë përputhet pra me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 4 Hekurkthyesve të cilët do të shërbejnë për vendosjen e armaturave të hekurit në të gjithë objektet b/a si puseta, puseta komandimi, puseta ajrimi, depo e re. Kjo kërkesë përputhet pra me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 2 teknikëve të mesëm të ndërtimit për organizimin e punëve në kantier, si dhe për mbarëvajtjen e proceseve të punës. Kjo kërkesë përputhet pra me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 2 manovratorëve të cilët do të shërbejnë për drejtimin e eskavatorëve, të kamioneve, për realizimin e volumeve të gërmimit, mbulimit, transportin e materialeve të ndërtimit dhe tubacioneve, si dhe shkarkimin/vendosjen e tyre në objekt. Kjo kërkesë përputhet pra me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 1 shoferi i cilët do të shërbejë për drejtimin e bobcatit, si dhe të kamionçinës, për sistemim e mbulimeve me dhera dhe transportin e materialeve të ndërtimit. Kjo kërkesë përputhet pra me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 1 Teknik mekanik i cili do të shërbejë për montimin dhe ndjekjen e proceseve të punës gjatë instalimit të saraqineskave. Kjo kërkesë përputhet pra me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 1 Bojaxhi/Suvaxhi i cili do të shërbejë për lyerjen e objekteve si depo uji etj, dhe realizimin e shtresave të suvasë. Kjo kërkesë përputhet pra me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 1 Muratori i cili do të shërbejë për ndërtimin e mureve të godinave të depos dhe realizimin e shtresave të suvasë. Kjo kërkesë përputhet pra me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 1 Hidroizoluesi i cili do të shërbejë për ndërtimin e hidroizolimit të depos dhe pusetave. Kjo kërkesë përputhet pra me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 10 punëtorëve të krahut, të cilët do të shërbejnë për realizimin e volumeve të gërmimit me krahë, rektifikimin e skarpatave të kanaleve ku do të vendosen tubacionet, mbulimet me krahë dhe përdorimin e tokmakut elektrik për mbulimet e kanaleve, gërmimet si dhe si ndihmës të hidraulikëve, karpentiereve, hekurkthyesëve etj për sistemimin, shkarkimin dhe transportin në kantier të materialeve të ndryshme. Kjo kërkesë përputhet pra me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 36 persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Shënim:** Për këtë pikë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr. 8.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë dokumentat provues :

*Listpagesat e sigurimeve shoqërore të konfirmuara nga organet tatimore, për periudhën kohore: Tetor 2024 - Dhjetor 2024, për punësimin e mesatarisht 36 personave”*

**Argumentimi:** Përcaktimi i numrit të punonjësve bazohet tek Ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore dhe tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës etj. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje Shtator 2024 -Nentor 2024, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përse kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës.

Numri i punonjësve të kërkuar është vendosur minimalisht 36 persona sipas kriterëve me siper: Perkatesisht 4 hidraulikë + 4 Karpentierë + 4 Hekurkthyes +2 Teknik të mesëm ndërtimi +2 manovrator të mjeteve të rënda+ 1 Teknik mekanik + 1 Bojaxhi/Suvaxhi+ 1 Murator+ 1 Hidroizolues+ 1 shoferë + 10 punëtorë krahu+ 4 ing+ 1 ing.drejtues teknik= 36.

Periudha kohore e listpagesave të sigurimeve shoqërore është përcaktuar periudha Tetor 2024 - Dhjetor 2024, në mënyrë që kriteri të përfshijë një periudhë sa më koherente.

Vlerësohet domosdoshmëria e stafit të punësuar për një periudhë të mëparshme, periudhën: Tetor 2024 - Dhjetor 2024, duke argumentuar se kjo shërben si tregues i një marrëdhënie të besueshme e të qëndrueshme midis punëdhënësit e punëmarrësit.

**2.2.6** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Statusi	Sasia
Eskavator me goma	në pronësi ose me qira	Copë 2
Eskavator me cekic me zinxhire	në pronësi ose me qira	Copë 2

Fadrome me goma (bobcat apo ekuivalente)	në pronësi ose me qira	Copë 1
Minieskavator	në pronësi ose me qira	Copë 1
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes nga 10 deri 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
Kamion me vinç	në pronësi ose me qira	Copë 1
Kamionçinë deri në 3.5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
Autobitumatriçe	në pronësi ose me qira	Copë 1
Autobot Uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 1
Autopompe betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
Motobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 2
Pompe Uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
Vibrator	në pronësi ose me qira	Copë 1
Motogjenerator / Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 1
Sondë për shpime horizontale per kalim tubash nen trasene e rrugës	në pronësi ose me qira	Copë 1
Aparature elektronike per kontrollin e presionit , pompe presioni deri 40bar per te realizuar procedure e testeve te presionit	në pronësi ose me qira	Copë 1
Autosondë për hapje pusi dhe vendosjen e tubave në pus	në pronësi ose me qira	Copë 1
Kompresor për futjen me presion të ajrit dhe solucionit në pus	në pronësi ose me qira	Copë 1
Aparat per ngjitje tubash me elektrofuzion	në pronësi ose me qira	Copë 1
Kompresor ajri	në pronësi ose me qira	Copë 1
Tokmak elektrik	në pronësi ose me qira	Copë 1
Rul	në pronësi ose me qira	Copë 1

Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Copë 1
Matrapik	në pronësi ose me qira	Copë 1
Rimorkiator	në pronësi ose me qira	Copë 1
Fabrikë asfalti, me vendndodhje në distancë teknikisht të pranueshme nga objekti.	në pronësi ose me qira	Copë 1
Fabrikë betoni ose kontratë furnizimi  Kur Fabrika e betonit është në pronësi , oe duhet të paraqesë edhe lejën mjedisore	në pronësi ose me qira	Copë 1
Dumper	në pronësi ose me qira	Copë 1
Grejder	në pronësi ose me qira	Copë 1

**Shënim:** Për këtë pikë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë dokumentat provues :

*a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) certifikaten e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm).*

*Për mjetet e siguruar me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti qe verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) certifikaten e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm). Mjetet të shoqerohen me kontratën perkatase te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi.*

*b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme targa e mjetit.*

*Autoriteti Kontraktor UKRK S.H.A., rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar nga OE.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e



Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Lloji dhe sasia e makinerive të kërkuara është përcaktuar në raport (në përpjestim) me punimet konkrete që do të kryhen, volumet e tyre dhe grafikun e punimeve.

*(Shënim: përcaktoni aktin ligjor apo nënligjor, në bazë të të cilit është bërë përlllogaritja teknike e numrit të punonjësve dhe mjetet/makineritë/pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës)*

## **2.2.8** Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese certifikata te vlefshme:

ISO 9001 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

ISO 14001 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

ISO 45001 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

ISO 39001 (Sistemi i menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

**Argumentimi 2.4:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

-Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë per Sistemin e manaxhimit te cilesise ISO 9001 (e vlefshme) për të garantuar kërkesat cilësore të materialeve të ndërtimit dhe punimeve të zbatimit.

-Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë per Sistemin e manaxhimit te mjedisit ISO 14001 (e vlefshme) për të garantuar rehabilitimin e plotë të sheshit të ndërtimit gjatë dhe pas kryerjes së punimeve me ndikime sa më të vogla në mjedis.

-Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë per Sistemin e manaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune OHSAS 18001 (e vlefshme) ose Çertifikatën ekuivalente të njohur nga Standardet shqiptare ISO 45001-2018 për të garantuar sigurinë e punëtorëve të zbatimit gjatë kryerjes së punimeve

-Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemi i menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor ISO 39001 (e vlefshme) ose Çertifikatën ekuivalente të njohur nga Standardet shqiptare ISO 39001-2012 për të garantuar sigurinë e punëtorëve të zbatimit gjatë kryerjes së punimeve

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

**Bashkangjitur ketij procesverbali dhe si pjese integrale e tij do te jene:**

- **Projekti i zbatimit.**
- **Specifikimet teknike për zbatimin e projektit**
- **Grafiku i punimeve**

**Afatet e realizimit të punimeve: 8 (tete) muaj nga data e nenshkrimit te kontrates**

Hartoi:

Thoma Koroveshi (Inxhinier Hidroteknik)

Ilia Papa (Ixhinier Gjeodet)

Ada Lumani (Jurist)